

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	09/08/2023	<p>Kërkesë për informacion ardhur nga një qytetar: Dëshiroj të informohem për procedurat e ndjekura nga ana e juaj, për zbatimin e ligjit nr. Nr. 57/2020 “Për Pyjet “.</p> <p>Pyetjet si me poshtë vijnë: 1) A keni inspektuar ju referuar nenit 35 pika 1, germa a) dhe germa b) te ligjit 57/2020 institucionin përgjegjës për pyjet pranë bashkisë Pogradec ? Nëse po, ku mundet të kërkoj të kem kopje të inspektimit apo inspektimeve? 2) A keni konstatuar shkelje ligjore përsa i përket zbatimit te nenit 16 pika 3 te ligjit 57/2020, dhe nëse po , çfarë lloj shkeljesh keni konstatuar? 3) A keni ju të dhëna se si, dhe sa janë zbatuar përcaktimet e ligjit 57/2020 , nenit 38, pika 7 nga ana e bashkisë Pogradec ?</p>	09/08/2023	<p>Përgjigjia e Pyetjes 1.</p> <p>Referuar shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 35 të ligjit nr, 57/2020, “Për pyjet”, Agjencia Kombëtare e Pyjeve në kuadër të sigurimit të performancës në sektorin e pyjeve, si dhe vlerësimit të gjendjes së pyjeve dhe impaktit të sektorit, kryen:</p> <p>a) monitorimin e treguesve kyç dhe nivelit të realizimit të politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat përgjegjëse në bashki për pyjet;</p> <p>b) mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore/nënligjore, akteve administrative, politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat e kontrollit të pyjeve në bashki dhe në zonat e mbrojtura, si dhe ndërhyrjet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në rastet kur vëren pamundësinë ose mosshkrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre.</p> <p>Struktura e kontroll inspektimit e AKP nuk kryen dhe nuk ka kryer inspektime në bashkinë Pogradec por sipas ligjit kryen kontroll për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore/nënligjore, akteve administrative, politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat e kontrollit të pyjeve në bashki.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>4) A keni të dhëna ju, nëse janë referuar, dërguar nga ana e bashkisë Pogradec, rastet e konstatimit të shkeljeve pranë gjykatave administrative për të kërkuar vlerën e dëmit të shkaktuar referuar ?</p> <p>5)A keni ju të dhëna sa prej tyre janë përcjellë në zyrat përbarimore për të vjelë vlerën e dëmit të shkaktuar nga kundërvajtësit nga ana e Bashkisë Pogradec?</p>		<p>Ligji shprehet qartë (pika 1/b e nenit 35) se inspektimi nga ana e Strukturës së kontroll inspektimit në AKP kryhet vetëm atëhere kur struktura e pyjeve e bashkisë nuk ushtron kompetencat ligjore dhe në këtë kuptim AKP nuk inspekton bashkinë por subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e pyjeve.</p> <p>Përgjigjia e Pyetjes 2.</p> <p>Referuar detyrimit të përcaktuar në pikën 3 të nenit 16 të ligjit ligjit nr, 57/2020, “Për pyjet” nga informacioni i dërguar nga ana e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore rezulton se në të gjitha bashkitë është ngritur struktura e menaxhimit dhe kontrollit të fondit pyjor, ku specialistët janë me arsim të lartë pyjor.</p> <p>Përgjigje e Pyetjeve 3, 4 dhe 5.</p> <p>AKP nuk disponon të dhëna nga bashkia Pogradec lidhur me rastet e dërguara në gjykatën kompetente lidhur me vjeljen e dëmit të shkaktuar, si dhe rastet kur vendimet përkatëse nëse ka, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë i janë dërguar Përbarimit Gjyqësor.</p> <p>Për këtë, kërkon informacion në Bashkinë Pogradec.</p>		
02	09/09/2023	<p>Kërkese për informacion:</p> <p>1- Sa është numri i fidanëve që janë mbjellë për ripyllëzimet duke filluar nga viti 2014 e deri më tani? Të dhënat për numrin e fidanëve të mbjellë të jenë të ndarë sipas viteve... 2- Sa është fondi i shpenzuar për ripyllëzimin që nga viti 2014 e deri më tani?</p> <p>3- A ka ministria një fidanishte të sajën apo i blen në privat fidanët e rinj? Nëse nuk ka</p>	09/09/2023	Deleguar te Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.	Përfunduar	Nuk ka

	<p>fidanishte, ku i blen fidanët e rinj për mbjellje dhe cila është garancia që ato i përshtaten klimës së vendit tonë? Ka më shumë kosto ngritja e një fidanishtje shtetërore apo blerja e fidanëve në privat?</p> <p>4 - Në vitin 2009, ish kryeministri Berisha nisi të ashtuquajturin “projekti i ullirit”, që parashikonte fillimisht mbjelljen e 20 milion rrënjë ullinj e arrorë, premtim që më pas shkoi në 50 mln rrënjë ullinj. Sa ka qenë realizimi i këtij projekti?</p> <p>5- Cilat janë projektet që parashikohet të aplikohen në vitet në vijim në rritjen e numrit të pemëve të mbjella? Sa është fatura financiare për zbatimin e këtij plani?</p>				
--	---	--	--	--	--